



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

NJOFTIM

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Klinë njofton se:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që nga data 18.09.2019 hap periudhën për aplikim në "Programin për Integrimin Social - Ekonomik të Fermave të Vogla në Komunitet". Përmes këtij programi MBPZhR-ja synon përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të fermerëve në zonat rurale, krijimin e vendeve të punës, si dhe rritjen e të ardhurave duke integruar fermerët e vegjël në sektorin bujqësor.

Investimet e ministrisë përmes Programit arrijnë vlerën prej 3 milionë euro dhe përmes këtij fondi do të mbështeten sektori i përpunimit të frutave, sektori i mishit, vezëve, qumështit, prodhimi i mjaltit, prodhimi, përpunimi dhe grumbullimi i produkteve pyjore, si dhe përpunimi i produkteve bujqësore në shtëpi.

Përfituesit e këtij programi mund të jenë të gjithë fermerët në përputhje me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural që plotësojnë kriteret e këtij Programi.

Afati për aplikim për këtë program fillon më 18 shtator dhe përfundon më 18 tetor 2019.

www.azhb/ks.net

Drejtori i BPZHR

Z. Naser Morina

